

VENDIM
Nr.842, datë 6.12.2011

**PËR MIRATIMIN E VLERËS SË KOMPENSIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË
KULTURAT BUJQËSORE E NË BIZNESE, NGA RESHJET E SHIUT DHE PËRMBYTJET, NË
QARKUN E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun Shkodër, në shumën 1 112 303 342 (një miliard e njëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e tre mijë e treqind dyzet e dy) lekë.

2. Miratimin e listave të familjeve dhe subjekteve të biznesit të qarkut të Shkodrës, së bashku me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kulturat bujqësore dhe në biznese, sipas listave të njëjësive të qeverisjes vendore, si më poshtë:

a) Lista e familjeve të qarkut të Shkodrës, me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kultura bujqësore, për bashkinë Shkodër; komunat Bushat, Dajç, Velipojë, Bërdicë, Ana e Malit, Rrethina, Qendër Koplik, Gur i Zi, Kastrat, Gruemirë dhe të tjera, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Lista e subjekteve të biznesit të qarkut të Shkodrës, me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në biznese, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Fondi prej 1 112 303 342 (një miliard e njëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e tre mijë e treqind dyzet e dy) lekësh të përballohet nga shuma, në të njëjtën vlerë, që do të paguajë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), në buxhetin e shtetit, në një llogari të veçantë.

4. Kryerja e pagesave për personat përfitues të bëhet sipas procedurave që do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, këshilli i qarkut Shkodër dhe prefekti i qarkut Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha